



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2024:149808  
Datë: 05.11.2024  
Numri i dokumentit: 06401738

K.Dh.Sh.II.nr.1855/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija - Ymeri dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit “ARAD 94” Shpk me seli në Prishtinë, me përfaqësues sipas autorizimit Florian Petani Avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, palës ndërhyrëse Komuna e Podujevës dhe kompania “Konstruktori ING 1969”, për anulim të vendimit PSH.Nr.2024/0201 i datës 03.05.2024, i nxjerrë nga Paneli Shqyrtues OSHP, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.257/2024 të datës 05.09.2024 në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit “ARAD 94” Shpk me seli në Prishtinë si e pabazuar, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.257/2024 të datës 05.09.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.257/2024 të datës 05.09.2024, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit “ARAD 94” Sh.p.k me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar të shtyhet ekzekutimi i vendimit PSH.Nr.2024/0201 i datës 03.05.2024, deri në marrjen e vendimit gjyqësor përfundimtar përkitazi me kërkesëpadinë, si e bazuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Me ankesë ka propozuar që të aprovohet në tërësi ankesa e propozuesit ashtu që të ndryshohet aktvendimi KA.nr.257/24 anulohet aktvendimi KA.nr.190/23 i datës 05.05.2023 ashtu që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesa e paditësit Arad 94 shpk, për shtyrjen ekzekutimit të vendimit OSHP 2024/0201 dt.03.05.2024, shtyhet ekzekutimi i vendimit OSHP 2024/0201 dt. 03.05.2024 deri në marrjen e vendimit

gjqësor përfundimtar përkitazi me kërkesëpadinë, detyrohet Autoriteti Kontraktues – Komuna e Podujevës që menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi të pezullojë ekzekutimin e kontratës publike nr.615-23-3422-5-1-1/c997 deri në nxjerrjen e një aktvendimi tjetër gjyqësor, ose të anulohet aktvendimi KA.nr.257/24 dt.05.09.2024 dhe çështja të kthehet në rivendosi pranë dhomave të shkallës së parë.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në kuptim të nenit 13 par. 6 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe Nenit 194 të LPK-së, dhe gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Paditësi "ARAD 94" Shpk me seli në Prishtinë nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar Av. Florian Petani pranë kësaj gjykate me datë 27.05.2024 ka parashtruar padi për anulim të vendimit PSH.Nr.2024/0201 i datës 03.05.2024, me propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, deri në marrjen e vendimit gjyqësor përfundimtar për padi. Paditësi, në kërkesën e tij për shkak të anulimit të vendimit me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit ka theksuar se ky mjet juridik paraqitet për shkak të plotësimit të kushteve procedurale kumulative nga neni 22.2 i LKA-së, sepse ekzekutimi i vendimit PSH.Nr.2024/0201 i datës 03.05.2024 i nxjerrë nga OSHP: Do t'i sillte dëm të padrejtë dhe vështirë të riparueshëm paditësit, se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe as nuk do t'i sillte dëm të madh palës kundërshtare. Argumentet që mbështesin shkaktimin e dëmit vështirë të ri riparueshëm paditësin, parashtrorjme se zbatimi i vendimit administrativ të atakuar, do t'i sillte dëm paditësit sepse me ekzekutimin e vendimit në fjalë paditësi kundërligjshëm dhe padrejtësisht do të privohej nga e drejta për t'iu nënshtruar një procedure të ligjshme, të drejtë dhe transparente dhe pa diskriminim ndaj të gjithë operatorëve ekonomik në procesin e përzgjedhjes për realizimin e aktivitetit lëndor të prokurimit; e drejta për t'u kualifikuar si operator i përgjegjshëm me çmim të ulët për implementimin e projektit "Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike Isa Boletini" me nr Prok:615-23-3422-5-1-1; mundësia e fitimit të përvojës profesionale në zhvillimin e aktivitetit të tij të rregullt ekonomik, në një ambient ekonomik të besueshëm ku funksionon rendi publik dhe sundimi i ligjit; përfitimet monetare të ligjshme që derivojnë nga implementimi i projektit lëndor.

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Administrativ i Gjykatës Komerciale me aktvendimin e atakuar KA.nr.257/2024 të datës 05.09.2024, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit "ARAD 94" Sh.p.k me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar të shtyhet ekzekutimi i vendimit PSH.Nr.2024/0201 i datës 03.05.2024, deri në marrjen e vendimit gjyqësor përfundimtar përkitazi me kërkesëpadinë, si e bazuar.

Gjykata e Shkallës së parë në arsyet e aktvendimit të ankimuar ka theksuar se në rastin konkret duke marrë parasysh rëndësinë e aktivitetit të prokurimit që ka të bëjë me ndërtimin e Shkollës së Mesme Ekonomike “Isa Boletini” në Podujevë dhe duke marrë parasysh pretendimet e AK, në raport me interesin publik se ndërprerja e punime do të ketë për pasojë vonesat në përmbushjen e planit dimanik ku planifikohet që shkolla të jetë në funksion për vijimin e mësimave për vitin e ardhshëm akademik, dhe për më tepër duke pasur parasysh se mjetet financiare të destinuar në programin buxhetor rrezikohet të humbin për shkak të suficitit pas përfundimit të vitit fiskal, gjykata vlerësoj se interesi publik për ndërtimin e shkollës e mbipeshën interesin juridik të paditësit për vendosjen e masës së sigurisë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Kolegjit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet nga Neni 22 i LKA në mënyrë që të shtyhet ekzekutimi i vendimit kontestues. Sipas Kolegjit të kësaj Gjykate me rastin e shtyrjes së ekzekutimit të vendimit, gjykata shqyrton dhe kufizohet vetëm në kushtet ligjore nga Neni 22 par. 2 i Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative në mënyrë që të shtyhet ekzekutimi i aktit administrativ.

Me dispozitën e Nenit 22 par.2 të LKA është paraparë që shtyrja e ekzekutimit të aktit administrativ mund të bëhet nën plotësimin e kushteve si në vijim: a) ekzekutimi i aktit administrativ do t’i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, b) shtyrja të mos jetë në kundërshtim me interesin publik, c) shtyrja nuk do t’i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare.

Sipas Kolegjit, qëndrojnë konstatimet e gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret akti i kontestuar mund t’i shkaktohej dëm të pariparueshëm paditësit nga eliminimi i procedurës së prokurimit, për vet faktin se që me vendimin e OSHP –se pretendimet ankimore të OE paditës si ofertues me i lirë, janë pranuar si të bazuara, dhe pavarësisht kësaj është lejuar AK që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit. Sipas Kolegjit një gjendje e tillë paraqet vetëm një nga kushtet që duhen të plotësohen në mënyrë kumulative konform Nenit 22 par.2 të LKA. Sidoqoftë, ky kusht duhet të vlerësohet edhe në raport me kushtin tjetër që ka të bëjë me interesin publik në zbatimin e vendimit. Rrjedhimisht, Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka balancuar kushtet ligjore nga Neni 22 i LKA duke vënë theksin në rëndësinë e aktivitetit të prokurimit që ka të bëjë me ndërtimin e Shkollës së Mesme Ekonomike “Isa Boletini” në Podujevë.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale arrijnë në përfundim se në këtë fazë të procedurës nuk mund të gjykohet dhe as të shqyrtohen pretendimet e paditësit lidhur me ligjshmërinë e aktit të kontestuar dhe se një çështje e tillë i takon gjyqimit meritator të rastit. Me

këtë rast, Kolegji mban qëndrimin se dëmi eventual që do të mund t'i shkaktohej paditësit mund të kompensohet nëse me rastin e gjykimit konstatohen shkelje në procedurën e prokurimit – gjë që gjykata nuk mund të lëshohet në vlerësime të tilla në këtë fazë të procedurës.

Së këndejmi, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Sa i përket vlerësimit të interesit publik si njëri prej kushteve ligjor nga Neni 22 par.2 të LKA-së, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar interesin publik në raport me objektin e shqyrtimit të shtyrjes së ekzekutimit. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative të gjitha kushtet për të aprovuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe atë kushti se shtyrja do ta dëmtonte interesin publik, dhe do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtarë. Rrjedhimisht, vlerësimi i këtij kriteri ndërlidhet me operimin e projektit për ndërtimin e shkollës – aktivitet ky i prokurimit që shqyrtohet në kuadër të interesit publik dhe se me hyrjen në procedurën e prokurimit dhe lidhjen e kontratës autoriteti kontraktues merr cilësinë e palës kontraktuese dhe si palë në procedurë merr edhe përgjegjësinë në raport me dëmin eventual që mund t'i shkaktohet palëve për shkak të parregullësive procedurale.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e shkallës së dytë  
Kom.Dh.shk.II.nr.1855/2024, me datë 24.10.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari  
Dren Rogova